TË DHËNAT TEKNIKE

ZEUS-AL

Bojra & Verniqe

ZEUSCRYL

100% BOJË ARILIKE
PËR PËRDORIM TË JASHTËM

PËRSHKRIMI TEKNIK

ZEUSCRYL është një bojë akrilike me bazë uji e cila bazohet në rezina speciale të tipit 100% akrilik i pastër dhe si rrjedhim ka një performancë të shkëlqyer.Është një produkt special që karakterizohet nga një mbulueshmëri shumë e mirë dhe është rezistent ndaj larjes, gërvishtjeve, dhe për më tepër ofron mbrojtje të shkëlqyer ndaj rrezeve ultra-violet dhe kushteve atmosferike. Boja nuk përbën rrezik për përdoruesin apo mjedisin. Nuk ka përmbatje metali.
Eshte e disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe në një shumëllojshmëri ngjyrash të prodhuara përmes sistemit të ngjyrave **ZEUS-AL**.
Është i përshtatshëm për përdorim të jashtëm.

CILËSITË

Duke qenë se është rezistente ndaj rrezeve ultra-violet dhe kushteve atmosferike, boja ruan ngjyrat të pandryshuara për një periudhë të gjatë kohore . Për më tepër, paraqet një mbulueshmëri shumë të mirë, është rezistente ndaj gërvishtjeve, mund të lahet lehtë me ujë duke qënë se nuk dëmtohet nga detergjentët. Aplikohet lehtë, nuk mban erë dhe është rezistente ndaj zverdhjes. Ka bardhësi perfekte. Produkti mund të aplikohet shumë lehtë me furçë, rul ose pistoletë.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për dekorimin e sipërfaqeve të jashtme, të cilat janë me suva, allçi, stuko, beton, dru, etj, veçanërisht në vendet ku kemi nevojë për mbrojtje ndaj rrezeve ultra-violet dhe kushteve atmosferike.

VOC (Përbërësit e Paqëndrueshëm Organik)
Vlera limit e BE: për këtë kategori produkti A/a (Bojra për mure dhe ambjente te jashtme me natyrë minerale) : 75g /l (2007) dhe 40g /l (2010).
Ky produkt përmban maksimalisht 20 g/l VOC.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. “Asti Gogoli”, ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com

ZEUSCRYL

100% BOJË ARILIKE
PËR PËRDORIM TË JASHTËM

APLIKIMI

Sipërfaqja që dëshirojmë të lyejmë duhet të jetë e pastër,e thatë, pa praninë e shtresave të vjetra të bojës, vajrave, yndyrnave, kripërave, etj. Sipërfaqet e dëmtuara duhet të stukohen më parë me SPECIAL STUCCO të **ZEUS-AL.** Sipërfaqet e reja ose sipërfaqet poroze të lyera më parë me gëlqere ose me bojë me cilësi të dobët, duhet të trajtohen më parë me një dorë astar LATEX të **ZEUS–AL** të holluar deri në masën 200% - 300% me ujë,ose me astar FIXDUR të **ZEUS-AL** të holluar deri në masën 100% me BRUSH SOLVENT No 100 dhe pas tharjes të aplikohen dy duar me **ZEUSCRYL**.

Hollimi për furçë ose rul: 5-10% me ujë sipas peshës.
Hollimi për pistoletë: 5-10% me ujë sipas peshës.
Aplikimi: Aplikoni 1-2 shtresa mbi sipërfaqen e pastruar dhe të përgatitur mirë.
Temperatura e përdorimit: 5 deri në 35°C.

TË DHËNA TEKNIKE

Ngjyra: E bardhë & ngjyrë
Rezina: Emulsion 100% akrilik i pastër
Densiteti (e bardhë): 1.50±0.01 gr/ml (EN ISO 2811.01-02, 20°C)
Viskoziteti i produktit në prodhim: 105±5 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Viskoziteti i produktit në magazinim: 110±10 KU (ASTM D 562-05, 25°C)
Substanca të ngurta sipas peshës (e bardhë): 70±1% (EN ISO 3251-03)
Substanca të ngurta sipas vëllimit (e bardhë): 48±1% (ISO 3233-98)
pH: 8.5-9.0 (ISO 976-96)
Temperatura minimale e formimit te filmit : 0 ºC (ASTM D 2354)
Qëndrueshmëria në paketim: 10/10 (1 muaj, 50°C) (ASTM D 1849-03)
Shkëlqimi, në 60°: 12± 3 (ELOT EN ISO 2813-99)
Koha e tharjes në 25°C:

- Tharja në sipërfaqe: 20-40 min
- Tharja ne brëndësi: 45-60 orë
- Rilyerja: pas 1-2 orë

Pika e ndezjes: n.a. (ELOT EN ISO 1523-02)
Ngjitja në çimento(ndër-prerë): 0 (ELOT EN ISO 2409-95)
Mbulimi: 12-13 m²/lit për shtresë në sipërfaqet e përgatitura mirë.

Shënim:

- Rekomandohet që sipërfaqet e lyera të lahen 20-30 ditë pas aplikimit të bojës, në rast se është e nevojshme.
- Mbi sipërfaqe me suvatim të freskët, rekomandohet që produkti të aplikohet të pakën 30-40 ditë më pas.
- Rekomandohet shmangia e përdorimit të produktit në temperatura nën 0°C ose pak para shiut.

ZEUS - AL Adresa: L.14, Rr. "Asti Gogoli", ish NPA, Shkozet - Durrës
Tel: +355 52 265 461 / E-mail: info@zeus-al.com
web: www.zeus-al.com